



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government



Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	Datë: 13.01.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.0-1020/2
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregullore Nr. 12. 030 - 56356 për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

17
11.01.2021
12.01.2021
0-1020/2

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

PËR/	z. Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Pushtetit Lokal
Cc:	z. Skender Reçica, Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Feim Osmani, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MPMS
NGA/OD/FROM:	Komisioni Ministror për Shqyrtimin e Ligjshmërisë dhe Përshtatshmërisë të Akteve Komunale të Kosovës: 1. Nafije Selimi, DPSF -kryesuese, 2. Ylber Aliu, DPP -anëtar, 3. Skender Asllani, DAP -anëtar 4. Shkëmbin Veliu, ZL -anëtar, 5. Hajrie Pajaziti, DFDIL -anëtare.
Lënda:	Përgjigje në kërkesën për konsultim paraprak
Lloji i aktit:	Rregullore për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës në Komunën e Glllogocit, Nr.12.030-56356 e datës 30.12.2020.
Data e shqyrtimit	11.01.2021

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë Nr.06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike, Komisioni ministror për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së akteve Komunale të Kosovës, ka pranuar kërkesë për konsultim paraprak ashtu siç parashihet në nenin 83 të

Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, nga Komuna e Glllogocit- aktin komunal si në vijim:

Rregullore për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Nr.12.030-56356 të datës 30.12.2020.

Komisioni ministror për shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së akteve komunale në kuadër të MPMS, ka shqyrtuar dhe ka konstatuar se:

- Rregullorja për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Nr. 12.030-56356, e datës 30.12.2020, e nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, është në harmoni me legjislacionin aktual të fushëveprimtarisë së MPMS ?

Vërejtje: Anëtarët e pranishëm janë nënshkruar në procesverbalin origjinal të takimit me rastin e shqyrtimit të aktit në fjalë.

Me respekt!